



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. \_\_\_\_\_ / 2012

Datë: 24.07.2012

Në mbështetje të nenit 101 paragrafi 2, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 10 parag. 1.3 dhe nenit 17 parag. 1 nënparag. 1.1, 1.2, 1.3 dhe parag 2 dhe 3 i Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, (në tekstin e mëtejme Këshilli), në mbledhjen e shtatë (VII), të mbajtur më datën 24.07.2012, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime të Kolegjit të Këshillit, në përbërje Bajram Ajeti dhe Bisera Spahi, anëtarë, lidhur me kërkesat nr. prot. 13.05/12 të datës 10.07.2012 dhe nr. 1323.2012, për monitorim të jashtëzakonshëm të paraqitura nga grup ankuesish dhe Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës, lidhur me konkursin në Qendrën Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Këshilli me qëllim të respektimit të rregullave dhe parimeve të shërbimit civil në QKUK, lëshon këtë:

### REKOMANDIM

- I. Të anulohet Shpallja publike e datës 15.05.2012 për vendet e punës - Drejtor Klinike, Drejtor Instituti dhe Drejtor i Shërbimeve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK-së).
- II. Obligohet, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtori Ekzekutiv i Qendrës Klinike Universitare e Kosovës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij rekomandimi, të rishpall Shpalljen publike, duke respektuar Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, parimet udhëheqëse në shërbimin civil, sipas këtij ligji dhe Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Sepse;

1. Organi i punësimit- Qendra Klinike Universitare e Kosovës, ka publikuar shpalljen publike më 15.05.2012, e cila shpallje nuk është autorizuar nga Ministria e Administratës Publike, ku nenit 4 parag.1, nenin 5 parag.1 dhe 2 dhe 6 parag.1 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, është

e përcaktuar se për rekrutimin e nëpunësit civil për një post të lirë apo të liruar paraprakisht duhet të autorizohet nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në Ministrinë e Administratës Publike, gjë që konstatohet se publikimi i konkursit të kontestuar nuk ka qenë i autorizuar. Sipas, nenit 15 parag. 3, të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: "Procedurat e rekrutimit, të cilat zhvillohen pa publikimin e shpalljes së rekrutimit ose, të cilat janë zhvilluar në rastet kur shpallja nuk është aprovuar nga MAP-i, janë të pavlefshme".

2. Komisionit të emëruar i është i dhënë përgjegjësia vetëm për intervistimin e kandidatëve, por jo edhe testimit, që konstatohet se testimi është mbajtur, por pa u bërë vlerësimi dhe bërja e raportit përfundimtar për rezultatet e arritura në testimin me shkrim të secilit kandidat veç e veç. Komisioni i emëruar është bërë në kundërshtim me nenin 7 parag. 1, të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse dy anëtar të komisionit nuk kanë status të nëpunësve civil, me që janë të emëruar në postet e tyre për Ndihmësdrejtor me vendim të Drejtorit Ekzekutiv e jo të zgjedhur sipas, Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, por as të Statutit të QKUK-së nenin 13 parag. 3, ku thuhet se: "Ndihmës Drejtori për Shëndetësi dhe Ndihmës Drejtori për Arsim zgjedhën në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil:". Po ashtu një (1) anëtar i Komisionit, nuk ka nivelin s'paku të njëjtë me postin e drejtorit klinik, por ka postin e ushtruesit të detyrës së Shefit të Zyrës për Çështje Administrativo/Juridike.
3. Shpallja publike është publikuar në kundërshtim me Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nenin 16 parag. 1 nën-parag. 1.5, 1.10 parag. 2 nën-parag. 2.1 dhe parag. 3, sepse në shpalljen publike nuk ka përshkrim të punës fare për detyrat dhe përgjegjësitë kyçe që duhet të përmbaj një përmbledhje të shkurtër të përshkrimit të punës në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore, kohëzgjatjen e emërimit, statusin e karrierës, periudhën provuese, postulatit e domosdoshëm si element i shpalljes se "Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabartë të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".
4. Me Ligjin nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 10 parag .1 nën-parag.1.2 thuhet së: "Këshilli vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;", dhe me nenin 16 parag. 1 nën-parag. 1.1 dhe 1.2, të Ligjit për Këshillin thuhet se: "Me qëllim të shqyrtimit të emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues, për të verifikuar nëse ato emërime janë bërë në pajtim me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli përfaqësohet se paku nga një (1) anëtar i cili do të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e çdo komisioni të emëruar për shqyrtimin e punësimit apo avancimit të kandidatëve për plotësimin e posteve të nivelit drejtues; pas rekomandimit të anëtarit të Këshillit që ka vepruar si vëzhgues,

Këshilli vendos nëse vendimet e komisioneve të emërimit janë marrë në pajtim me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon me shkrim organit të punësimit, nëse vendimet e komisioneve të emërimit nuk janë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës”, ku konstatohet se organi i punësimit nuk e ka ftuar Këshillin të marrë pjesë si vëzhgues në këtë proceduar të rekrutimit, që ka pasur obligim ligjor, sipas dispozitave ligjore të këtij ligji.

5. Organi i punësimit më datën 24.10.2011, i është drejtuar Ministrisë së Administratës Publike/Departamentit Ligjor, me kërkesën nr. prot. 6071 për interpretim ligjor për punëtorët shëndetësor dhe jo shëndetësor, ndërsa MAP gjegjësisht Departamenti ligjor, japë Opinionin ligjor nr. prot. 3984 të datës 02/11/2011, dhe konstaton se sipas, Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Drejtorët e klinikave/ institucioneve që janë mjekë janë nëpunës civil të nivelit drejtues pasi aktiviteti i tyre kryesor është administrativë dhe duhet të ju nënshtrohen fushëzbatimit të Ligjit për shërbimin civil, mirëpo edhe për kundër këtij opinionin nga ana e QKUK-së nuk është respektuar si i tillë.

III. Rekomandimi duhet të përmbushet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimit të tij dhe të njoftohet Këshilli.

Rekomandimi i u dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së
- Drejtorit Ekzekutiv të QKUK-së,
- Menaxherit të personelit në QKUK dhe MSH
- Ministrit të MSH-së dhe
- Arkivit të Këshillit.

Mehdi GECI

---

Kryetar i Këshillit